

Deklaratë miratimi

për përpunimin e të dhënave të mia personale

Unë jam dakort, që Jugendmigrationsdienst (JMD)

të përpunojë të dhënat e mia personale, siç përshkruhet në udhëzimet e bashkëngjituara mbi përpunimin e të dhënave.

Mua më janë shpjeguar udhëzimet lidhur me përpunimin e të dhënave, në veçanti unë jam udhëzuar për natyrën dhe qëllimin e përpunimit të të dhënave, dhe në lidhje me të drejtën time për të revokuar në çdo kohë këtë miratim. Revokimi vlen për të ardhmen. Përpunimi i të dhënave të mia mbetet i ligjshëm deri në momentin e revokimit tim.

Për mua është i njohur fakti, se unë mund të kundërshtoj në çdo kohë përpunimin e të dhënave – sipas kushteve të përcaktuara në udhëzimet mbi përpunimin e të dhënave -.

Unë e kam kuptuar miratimin. Me mua janë diskutuar pyetjet e hapura.

Emri: _____
(Vorname)

Mbiemri: _____
(Nachname)

Vendi, data
(Ort, Datum)

Nënshkrimi i personit të ri në moshë
(Unterschrift des jungen Menschen)

Udhëzime lidhur me përpunimin e të dhënave

Shoqëruar nga Shërbimi për Migracionin e të Rinjve

Emri/Mbartësi i shërbimit për migracionin e të rinjve (JMD):

(Name/Träger des Jugendmigrationsdienstes)

Të dhënat e kontaktit të punonjësit/punonjësës së JMD-së:

(Kontaktdaten des*der JMD-Mitarbeiter*in)

Të dhënat e kontaktit të personit të autorizuar për mbrojtjen e të dhënave:

(Kontaktdaten des*der Datenschutzbeauftragten)

Dispozitat e ligjit në mbrojtje të të dhënave të kishës protestante në Gjermani, të përmendura këto në sqarimin vijues (DSG-EKD) vlejné vetëm për sa kohë që shërbimi për migracionin e të rinjve qëndron nën sponsorizimin e kishës protestante, apo të ligjit në mbrojtje të të dhënave të kishës katolike (KDG) vlejné vetëm, nëse qëndrojnë në sponsorizimin e kishës katolike. Nëse nuk bëhet fjalë për asnjërën prej tyre, atëherë këto nuk do të vlejné, dhe mbeten vetëm rregullat e ligjeve të përgjithshme të përmendura, si për shembull Rregullorja Evropiane për Mbrojtjen e të Dhënave (DSGVO) dhe Ligji Federal për Mbrojtjen e të Dhënave (BDSG).

Shërbimi për Migracionin e të Rinjve i përmendur më lart është renditur nën **(Luteni të kryqëzoni atë që duhet):**

- Asnjë sponsorizim kishtar (keine kirchliche Trägerschaft)
- Sponsorizim i kishës protestante (Evangelische kirchliche Trägerschaft)
- Sponsorizim i kishës katolik (Katholische kirchliche Trägerschaft)

1. Qëllimi i përpunimit të të dhënave

Punonjësi/punonjësja i/e lartpërmendur i/e JMD-së dhe/ose përfaqësuesi i tij/saj më mbështetin gjatë integritit në Gjermani. Për këtë ai/ajo krijon një skedar elektronik të dosjes sime në softuerin „JMD i-mpuls“ dhe në rast nevojë një skedar të dosjes së rastit në formën e letrës. Në atë dokumentohen të dhënat e mia personale në përputhje me DSGVO-në, dhe me BDSG-në, ose nëse është e nevojshme edhe të dispozitave të tjera të rregulloreve përkatëse në mbrojtje të të dhënave (për shembull DSG-EKD, KDG ose të ligjeve në mbrojtje të të dhënave të landeve). Përveç kësaj, të dhënat e mbledhura për mua përdoren për studim statistikor. Vlerësimi statistikor bëhet vetëm në formë anonime.

2. Volumi i përpunimit të të dhënave / Vullnetarizimi

Lloji dhe volumi i të dhënave varen nga ajo, se çfarë informacionesh u jap unë punonjësve/punonjësve të JMD-së. Këtu hynë veçanërisht të dhënat e denja për mbrojtje, si për shembull lidhur me prejardhjen time etnike (Neni 9 i DSGVO;

§ 13 DSG-EKD; § 11 KDG).

JMD-ja i merr të dhënat vetëm personalisht nga unë. Të dhënat janë me dëshirë. Nëse jap të dhëna, atëherë miratoj përpunimin e tyre për qëllimet e deklaruara në këto udhëzime. Nëse i refuzoj të dhënat, atëherë mund të marr vetëm këshilla; Dhe kështu nuk do të jetë i mundur pranimi në Case Management.

3. Baza ligjore për përpunimin e të dhënave

Përpunimi i të dhënave të mia personale bëhet kryesisht për përmbushjen ose fillimin e marrëdhënies së mentorimit ndërmjet meje dhe JMD-së në mbështetje gjatë integritit (Neni 6 paragrafi 1 lit. b DSGVO; § 6 paragrafi 1 numër 5 DSG-EKD; § 6 paragrafi 1 lit. c KDG) si edhe nër shkak të nevojës për përmbushjen e detyrave të lidhura me interesin publik të JMD –së (Neni 6 paragrafi 1 lit. e DSGVO; § 6 paragrafi 1 numër 3 DSG-EKD; § 6 paragrafi 1 lit. f KDG). Përveç kësaj, përpunimi i të dhënave bëhet duke u bazuar në miratimin tim të dhënë këtu (Neni 6 paragrafi 1 lit. a; 9 paragrafi 2 lit. a DSGVO; § 6 paragrafi 1 numër 2; 13 paragrafi 2 numër 1 DSG-EKD; § 6 paragrafi 1 lit. b; 11 paragrafi 2 lit. a KDG).

4. Kategoritë e marrësve të të dhënave

Punonjësi/punonjësja i/e JMD-së dhe/ose kolegu i tij/kolegja e saj në JMD mund të dokumentojnë, përpunojnë, shikojnë dhe vlerësojnë të dhënat e mia personale. JMD-ja ka nevojën për ndihmë nga kompanitë që drejtojnë serverin dhe softuerin, ku qëndrojnë të ruajtura të dhënat e mia personale. Këto janë kompania Intevation GmbH/Osnabrück (për software) dhe kompania Hostway Deutschland GmbH (për server). Këto kompani mund të shohin të dhënat e mia personale vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe vetëm me porosi të JMD-së dhe nuk lejohen në asnjë mënyrë që t'i përcjellin ato më tej.

Programi financohet nga Ministria Federale për Familjen, të Moshuarit, Gratë dhe Rininë (BMFSFJ). Për qëllime vlerësimi dhe zhvillimi të mëtejshëm të programit përmes (BMFSFJ)-së, një kopje anonime e dosjes sime të lëndës i përcillet një serveri qëndror. Në një vlerësim nuk ka mundësi të arrihet përfundimi lidhur me dosjen time të rastit ose në lidhje me mua si person. Akses në këtë server kanë vetëm mbartësit e JMD-së të lartpërmendur, Zyra e Shërbimit të Shërbimeve për migracionin e të rinjve dhe (BMFSFJ)-ja.

5. Kohëzgjatja e ruajtjes së të dhënave

Të dhënat e mia personale do të fshihen nga dosja e lëndës pas përfundimit të mbështetjes sime nga JMD-ja, dhe atëherë këto bëhen anonime. Një kopje rezervë e dosjes sime do të mbishkruhet pas 5 javësh, dhe kështu të dhënat e mia personale nuk do të mund të rivendosen më. Të dhënat e mbetura janë anonime dhe nuk mund të më referohen më mua si person.

Çdo ruajtje e mëtejshme e të dhënave mund të jetë e nevojshme në lidhje me proceset gjyqësore dhe për të siguruar prova në kuadrin e dispozitave ligjore të parashkrimit. Këtu duhet patur parasysh në veçanti perioda e rregullt trevjeçare e parashkrimit, në rast të veçantë afatet e parashkrimit arrijnë deri në 30 vjet.

Në afatet e lartpërmendura duhet të kihet parasysh, se momenti i fshirjes së vërtetë, respektivisht i kufizimit të përpunimit mund të zgjatet ndryshëm edhe një herë në fillim të këtyre afateve për shkak të rregullave të ndryshme.

Për shkak të konstelacioneve të ndryshme për një apelim ndaj detyrimeve përkatëse të ruajtjes dhe fillimit të tyre, informacione të sakta mbi kohëzgjatjen dhe fshirjen e të dhënave mund të jepen vetëm me kërkesë në raste individuale. Për këtë ne i referohemi të drejtave tuaja për informacion, të paraqitura në paragrafin tjetër.

6. Të drejtat e mia

Nëse kam dëshirë, atëherë punonjësi/punonjësja i/e JMD-së duhet të më tregojë se cilat të dhëna mbi mua janë të dokumentuara (Neni 15 DSGVO; § 19 DSG-EKD; § 17 KDG). Të dhënat e gabuara mbi mua duhet të korrigjohen nga punonjësi/punonjësja i/e JMD-së (Neni 16 DSGVO; § 20 DSG-EKD; § 18 KDG). Në kushte të caktuara, kam të drejtë që të dhënat e mia të fshihen, ose të kufizohen ndaj përpunimit. Kushtet paraprake për këtë janë të rregulluara në nenin 17 ose 18 të DSGVO-së, respektivisht §§ 21; 22 DSG-EKG ose §§ 19; 20 KDG. Në këto raste unë mund edhe të kërkoj, që të gjithë marrësit e të dhënave, të vihen në dijeni për fshirjen e të dhënave ose kufizimin ndaj përpunimit. Në rrethana të caktuara, unë kam të drejtë që të dhënat e mbledhura nga unë, të më lihen në dispozicion në një format të strukturuar, të përdorshëm dhe të lexueshëm të shkruar me makinë (Neni 20 DSGVO; § 24 DSG-EKD; § 22 KDG).

Nëse unë nuk kam më dëshirë, që në bazë të këtij miratimi të përpunohen të dhënat e mia, atëherë unë kam të drejtë në çdo kohë që t'a tërheq mbrapsht miratimit (Neni 7 paragrafi 3 DSGVO; § 11 paragrafi 3 DSG-EKD; § 8 paragrafi 6 KDG). Revokimi shërben për të ardhmen. Përpunimi i të dhënave të mia deri në momentin e revokimit është i ligjshëm.

Nëse jam i mendimit, që përpunimi i të dhënave të mia shkel ligjin në mbrojtje të të dhënave, atëherë unë kam të drejtën e ankimit tek një autoritet mbikqyrës (Neni 77 DSGVO; § 46 DSG-EKD; § 48 KDG).

Listën e autoriteteve mbikqyrëse së bashku me adresat do t'i gjej nën:

https://www.bfdi.bund.de/DE/Infothek/Anschriften/Links/anschriften_links-node.html

7. E drejta ime për kundërshtim

Unë kam të drejtë në çdo kohë për të kundërshtuar përpunimin e të dhënave të mia sipas nenit 21 DSGVO; § 25 DSG-EKD; § 23 KDG. Kjo vlen nëse të dhënat e mia personale përpunohen në bazë të

- Nenit 6 paragrafi 1 S. 1 lit. e DSGVO (kryerja e një detyre që është në interesin publik,) ose
- Nenit 6 paragrafi 1 S. 1 lit. f DSGVO (ruajtja e interesave legjitime të përgjegjësit ose të një pale të tretë) ose
- § 6 paragrafit 1 numër 1 DSG-EKD (një dispozitë ligjore lejon përpunimin e të dhënave personale ose i kërkon ato) ose
- § 6 paragrafit 1 numër 3 DSG-EKD (për përmbushjen e detyrave të organit përgjegjës) ose
- § 6 paragrafit 1 numër 4 DSG-EKD (kryerja e një detyre tjetër që është në interes të kishës) ose
- § 6 paragrafit 1 numër 8 DSG-EKD (ruajtja e interesave legjitime të një pale të tretë) ose
- § 6 paragrafit 1 lit. f) KDG (kryerja e një detyre, që është në interes të kishës) ose
- § 6 paragrafit 1 lit. g KDG (ruajtja e interesave legjitime të përgjegjësit ose të një pale të tretë)

Kusht më tej është, që për kundërshtimin të ekzistojnë arsyet, që dalin nga situata ime e veçantë.

Në çdo kohë, dhe pa dhënë arsyet, mund të ngre kundërshtim kundër përpunimit të të dhënave të mia, nëse këto do të përdoren për reklamë direkte apo për sigurimin e mjeteve monetare.

Kundërshtimi vlen për çdo profilim të lidhur me qëllimet e mësipërme të përpunimit.